

20240741578

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

PËR GARANCINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR DETYRIMET E MARRËVESHJES SË HUASË PËR FINANCIMIN SHITESË TË PROJEKTIT PËR PËRMIRËSIMIN DHE ZHVILLIMIN E RRUGËVE, E CILA DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS NDËRKOMBËTARE TË RINDËRTIMIT DHE TË ZHVILLIMIT - BANKA BOTËRORE DHE NDËRMARRJES PUBLIKE TË RRUGËVE SHTETËRORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes së huasë për financimin shtesë të Projektit për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve, e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Banka Botërore dhe Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, në vlerë prej 31.000.000 eurove, nëse Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore nuk i përmbush dhe nuk i servison detyrimet e Marrëveshjes së huasë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen e huasë nga neni 1 i këtij ligji, e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Banka Botërore dhe Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore për financimin shtesë të Projektit për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që rezultojnë nga Marrëveshja e huasë së cekur në nenin 1 të këtij ligji, si dhe servisimin e huasë do t'i kryejë Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore nga të hyrat që realizon, në afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e huasë nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 4

Afati i shlyerjes së huasë së theksuar në nenin 1 të këtij ligji është 16 vjet, duke përfshirë periudhën e ngrirjes prej tre vjetësh.

Norma e interesit është EURIBOR-i gjashtëmujor me interval variabil.

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe Zhvillimit – Bankës Botërore provizion të njëhershëm në vlerë prej 0.25% të mjeteve vetanake.

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe Zhvillimit - Bankës Botërore provizion në vlerë prej 0.25% të pjesës së patërhequr të huasë çdo vit.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rezultojnë nga Marrëveshja e huasë nga neni 1 i këtij ligji dhe Marrëveshja e garancisë, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve të kryera ndaj Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, të destinuar për realizimin e Projektit për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve, të financuar nga Marrëveshja e huasë nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e heqjes (zbritjes) së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/mallrave i kryer nga Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore, të destinuar për realizimin e Projektit për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve, të financuar nga Marrëveshja e huasë nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar, detyrimet e importit dhe akciza e energjensave, si dhe tatimi i automjeteve motorike kohëzgjatjen e projektit.

Për qarkullimin e realizuar ndaj Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, që destinohet për realizimin e Projektit për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve, financuar nga Marrëveshja e huasë nga neni 1 i këtij ligji, për të cilin rezulton të jetë debitor tatimor në përputhje me nenin 32 pika 4 dhe nenin 32-a nga Ligji i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar lirohet nga detyrimi i përlogaritjes dhe pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar.

Obliguesi tatimor, i cili realizon qarkullim për të cilin është liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, në pajtim me paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, krahas emrit (emërtimit) të pranuesit të së mirës ose të shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë përcakton edhe emërtimin e projektit dhe emërtimin e Marrëveshjes së huasë së cekur në nenin 1 të këtij ligji.

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore, gjatë importit të të mirave/mallrave të liruara sipas paragrafit (2) të këtij neni, duhet t'i dorëzojë organit doganor kompetent kopje të marrëveshjes së huasë nga neni 1 i këtij ligji, si dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuara janë të destinuar për realizimin e Projektit për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve, i financuar nga Marrëveshja e huasë nga neni 1 i këtij ligji.

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, si dhe importi i të mirave/mallrave nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk mund ta tejkalojë vlerën e marrëveshjes ndërmjet Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore dhe kontraktuesit të përzgjedhur për kryerjen e çështjeve kontraktuese të destinuar për realizimin e financimit shtesë të Projektit për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve, të financuar nga Marrëveshja e huasë së cekur në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 7

Të mirat/mallrat që janë liruar nga pagesa e detyrimeve të importit në bazë të nenit 6, paragrafi (2) të këtij ligji, në periudhë prej tre vjetëve nga dita e importit, nuk mund të tjetërsohen, t'i jepen në shfrytëzim dikujt tjetër, të huazohen ose ndryshe të shfrytëzohen për qëllime tjera dhe jo për ato që është liruar nga pagesa e detyrimeve importuese, para se të jenë paguar detyrimet importuese. Këto (të mirat/mallrat) nuk guxojnë të jepen si kolateral, të huazohen ose të jepen si sigurim për detyrime tjera.

Nëse poseduesi i së drejtës, para përfundimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, të mirat/mallrat që kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të nenit 6, paragrafi (2) të këtij ligji, ka për qëllim t'i shfrytëzojë për qëllime tjera, e jo për ato për të cilat janë liruar nga pagimi i detyrimeve importuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor tek organi doganor.

Vlerën e borxhit doganor nga paragrafi (2) i këtij neni, organi doganor e përlogarit në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve që kanë qenë të vlefshme në momentin e parashtrimit të kërkesës për pagesën e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave të paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, vlera e borxhit doganor, përlogaritet në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve në momentin e pranimit të deklaratës doganore, në bazë të së cilës mallrat kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve të importit.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.